

SYLLABUS: Financat Personale

Të dhëna bazike të lëndës			
Njësia akademike:		Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Prishtinës	
Titulli i lëndës:		Financat personale	
Niveli:		Bachelor	
Statusi lëndës:		Zgjedhore	
Viti i studimeve:		Viti II-të, semestri III-të	
Numri i orëve në javë:		2+1	
Vlera në kredi – ECTS:		4 ECTS	
Koha / lokacioni:			
Mësimdhënësi i lëndës:		Prof.ass.dr.Arbër HOTI	
Detajet kontaktuese:		arber.hoti@uni-pr.edu	
Përshkrimi i lëndës		Ky kurs integron konceptet e ekonomisë dhe të financave personale për të ndihmuar studentët të kuptojnë më mirë implikimet e ngjarjeve ekonomike dhe të marrin vendime financiare të informuara. Financat personale siguron mjetet e nevojshme për studentët që të fitojnë shkathhtësi ekonomike dhe financiare. Kursi gjithashtu ofron një sërë aplikacionesh praktike për të ndihmuar studentët të kuptojnë kompleksitetin e vendimmarrjes financiare.	
Qëllimet e lëndës:		Ky kurs ka për qëllim të nxisë një shkallë të pavarësisë financiare dhe besueshmëri mbi tema të tilla si buxheti, planifikimi i karrierës, pagesa e taksave, arritja dhe përdorimi pozitiv i kredisë, mundësitë për investime dhe sigurimi.	
Rezultatet e pritura të nxënies:		Studentët që përfundojnë kursin do të jenë në gjendje të llogarisin vlerën monetare të arsimit shtesë, të vlerësojnë projektet e ardhshme të biznesit, të investojnë dhe të vlerësojnë letrat me vlerë financiare dhe të planifikojnë për të ardhmen e tyre.	
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënës të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren			
Kollokfiime, seminare	1	2	2

Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	10	20
Përgatitja përfundimtare për provim	1	1	1
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	1	2	2
Projektet, prezantimet, etj	1	15	15
Totali			100
Metodologjia e mësimdhënies:	Përcjellja e rregullt e ligjëratave dhe ushtrimeve është esenciale. Studentët të cilët janë të rregullt kanë sukses ndërsa ata të cilët nuk shkojnë rregullisht në orë kanë probleme. Leximi i rregullt i kapitujve të përcaktuar më parë. Mësimi i kësaj lënde është i vazhdueshëm, kuptimi i koncepteve të reja është ngushtë i lidhur me mësimin e koncepteve nga kapitujt paraprak. Mundohuni të zhvilloni kuptimin e koncepteve. Mos tentoni të mbani në mend materialet. Në të shumtën e rasteve mbajtja mend nuk do të ndihmojë në studimin tuaj. Në këtë lëndë detyrat në të shumtën e rasteve kërkojnë të aplikoni konceptet e mbuluara më herët dhe të mendoni për materialet e prezantuara më herët. Këto detyra nuk mund të kryhen pa i trajtuar në esencë problemet dhe pa menduar mirë. Kjo na jep të kuptojmë se nuk duhet të ngutemi në fillimin e kryerjes së detyrës në formën teknike për detyra të caktuara. Duhet të kaloni pak kohë duke konsideruar mësimet e mbuluara në klasë dhe kërkesat lidhur me detyrat specifike.		
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i studentëve konsiston në: • Pjesëmarrja në ligjërata: 10 pikë • Punimi seminarik: 10 pikë • Testi I (kolokiumi): 40 pikë • Testi II (kolokiumi): 40 pikë		
Literatura			
Literatura bazë:	Personal Finance, 10th Edition, by E. Thomas Gorman and Raymond E. Forgue, publisher: Southwest-Western Cengage Learning. Keown, Arthur J. Personal finance. Pearson, 2019 (shqip).		
Literatura shtesë:	Personal Financial Literacy, Pearson Education, Inc./Prentice-Hall Publishing, 2010 ©. Jeff Madura, Mike Casey, Sherry J. Roberts, authors.		

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Njohtimi me sillabusin
Java e dytë:	Vlera kohore e parasë, kalkulatorët financiarë
Java e tretë:	Huazimet e konsumatorëve
Java e katërt:	Kursimet dhe investimet
Java e pestë:	Planifikimi për pensionim
Java e gjashtë:	Inflacioni, fuqia blerëse dhe FED
Java e shtatë:	Huazimet afatgjata
Java e tetë:	Testi 1
Java e nëntë:	Taksat dhe tatimet personale
Java e dhjetë:	Parimet e probabilitetit dhe rreziku/kthimi
Java e njëmbëdhjetë:	Risku, leverazhi dhe planifikimi i pensionimit
Java e dymbëdhjetë:	Paragjykimet në financat konsumatore
Java e trembëdhjetë:	Rast studimi
Java e katërmëdhjetë:	Përgatitje për testimin final
Java e pesëmbëdhjetë:	Testi final
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
Vijimi i rregullt i ligjëratave dhe ushtrimeve është i obliguar për të gjithë studentët e rregullt. Të gjithë studentët janë të obliguar që t'i përfillin rregullat e mirësjelljes: mbajtja e qetësisë, ç'kyqja e telefonave celularë dhe hyrja në sallë me kohë.	